



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 30-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29. 06. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Adelina Krasniqi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Lulzim Rustemi, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Ali Stublla, anëtar
22. Valbona Shillova, anëtar
23. Burbuqe Ilazi, anëtar
24. Vlora Buja, anëtar
25. Arben Bahtiri, anëtar
26. Edita Gashi, anëtar
27. Ramiz Qeriqi, anëtar
28. Zoran Çirkovic, anëtar
29. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së

5. Fauz Xhemajli, Drejtor i DA
6. Avni Olluri, Drejtor i GJ.K
7. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
8. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
9. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
10. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
11. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
12. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
13. Behar Krasniqi, zyra ligjore
14. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
15. Bekim Krasniqi, "YAHR"
16. Përfaqësues të OJQ "POLIS" (1)
17. Përfaqësuesit e mediave
18. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
19. Bajram Zaskoku, përkthyes shqip-serbisht
20. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Ramiz Qeriqi, propozoj që në rend dite të hyn edhe një pikë edhe fjala është për shqyrtimin e marrjes së tokave atyre që ua kemi dhënë në shfrytëzim atyre që kanë punu ju kanë marrë e atyre që nuk kanë punuar nuk ju kanë marrë.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marr dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim e gjithashtu e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27vota për, të anëtarëve prezent për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 28 dhe 29-të e KK-së
2. Propozim Vendim për Korrnizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019
3. Propozim Vendim për Hapjen e Trasesë së Rrugës në Zonën Kadastrale Konjuh
4. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së "MABCO CONSTRUCTIONS" SHPK të përzgjedhur nga Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit
5. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së "TROIKANA AL MINING" SHPK të përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit
6. Propozim Vendim për Themelimin e Zonës Ekonomike në ZK Qylagë
7. Propozim Vendim për miratimin e nismës së Kuvendit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Lipjanit në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët.
8. Propozim Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Gjilanit në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët.
9. Propozim Vendim për miratimin e Planit të mobilitetit urban për Komunën e Lipjanit
10. Propozim Vendim për Miratimin e Strategjisë për Informim dhe marrëdhënie me Publikun e Komunës së Lipjanit.

Pastaj Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush të shtoj diqka para se të kaloj në punë sipas rendit të ditës.

Florent Hoxha, ne shpesh herë e kemi ngrit shqetësimin për pronën e komunës që është te tregu i kafshëve dhe aty janë vu shiritat dhe është përmend disa herë nga Kryetari dhe Nënkryetari është thënë se janë t'u zhvillu disa procedura nga prokurimi dhe dua ta di deri ku ka shkuar ky proces, e siqë dihet për atë pronë është shpall interesi i përgjithshëm.

Hajrije Salihu, unë kam pyetje konkrete por së pari do të flas e pastaj do të bëj pyetje.

Unë jam punëtorë e arsimit dhe kam pasur nderin dhe privilegjin që në mesin e nxënësve të mi ka pasur edhe martir edhe dëshmorë dhe falë gjakut të tyre ne sot jemi këtu.

Unë kam një pyetje konkrete për shkollën e Dobrajës e cila mban emërin e dy dëshmorëve dhe unë kam respekt të veçant për familjen Breznica që i biri i tyre është ra për këtë tokë dhe të gjithë banorët e Lipjanit e dijnë të dallojnë se cilët janë dëshmorët e cilët janë martirët e sidomos Drejtori i shkollës i cili është historian duhet të dijë se cili është dëshmorë e cili është martir. Unë e di që është bërë një kopromis për emrin e shkollës por datë rënja e dëshmorit nuk mund të ndryshoj. Unë kam pyetje konkrete se a bënë kokë në vete Drejtori për hekjen e emërtit të dëshmorit se unë e di që ka procedura për vënien e emrit por edhe hekjen e emrit ka procedura andaj dua përgjegjëje nga Drejtori i Drejtoratit për arsim ose nga Kryetari i Komunës.

Ramiz Qeriqi, i kam dy kërkesa njëra është për shtrimin e rrugës Afërdita së paku me zhavor dhe kërkesa e dytë është rruga Dobrajë-Poturovc që të vëhet një pasqyrë.

Lulzim Rrustemi, kam dy pyetje e para sa puëtor janë të punësuar në komunë me kontratë mbi vepren dhe nga cilat kode buxhetore paguhen dhe e dyta gjatë mbajtjes së testit të arritshmërisë dhe testit kombëtar janë vërejt selektive në zgjedhjen e stafit dhe personelit të administratës ku punëtorët e vjetër nuk janë përfshi ndërsa janë përfshi edhe punëtorë të rinj të administratës dhe ky selektiv është bërë për shkak të medijëve.

Enver Kozhani, është kërkesë e banorëve të fshatrave Ribar i Madh dhe Zllakuqan për vendosjen e pengesave në fshatin Hallaq i Madh të cilat janë vu jashtë standardeve e gjithashtu pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike se a ka pasur pelqim për vendosjen e pengesave.

Blerim Gashi, i kam dy shqetësime e para për projektin e DEMOS-it që jemi në bashkë financim dhe konsideroj se ky projekt nuk është kryer tërësisht dhe e dyta kemi shumë pishina në Komunën tonë dhe pyes se a i plotësojnë kushtet sanitare dhe të sigurisë dhe a monitorohen nga organi kompetent.

Valbona Shillova, unë do t'i paraqes disa shqetësime të banorëve dhe e para është kontinjerët nëntokësor në Lipjan të cilët shumë rrall po pastrohen dhe kundërmojnë erë të rëndë e gjithashtu kontinjerët të ndërtesa FFB TRADE po zhvendosen nga personat e papërgjegjshëm dhe herë bartën në njërin anë herë në anën tjetër dhe janë afër parkut ku luajnë fëmijët dhe konsideroj se duhet të hiqen nga aty. Shqetësim tjetër është qështja e Lumit "Sitnica" ku është shpall tenderi por nuk e dijmë se që është bërë më tutje me këtë tender.

Ali Stublla, Jeta e Re ende nuk është përfshi në rexhistrin e kadastrit e gjithashtu shqetësim tjetër është hedhja e mbeturinave për rreth rrugës në afërsi të qytetit.

Xhavid Maholli, paraqiti shqetësimin e qytetarëve të Gadimes meqë gjatë ndërtimit të autostradës u janë mbyllur rrugët që qojnë në ara dhe kërkojnë nga Komuna që të ju bëjnë zgjidhje për këtë qështje.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se besoj se Drejtori i administratës dhe zyra për informim meritojnë për inqizimin e mbledhjeve të Kuvendi dhe me këtë do të rritet performanca e Kuvendit.

Unë jam këtu për t'ju përgjigjur qytetarëve dhe pyetjeve të qytetarëve dhe të delegatëve.

Sa i përket pyetjes së Luanit për pronat që i kemi dhënë në shfrytëzim është pyetje me vend dhe ju them se shumë shfrytëzues pronat që u kemi dhënë i kanë lënë në hipotekë dhe në momentin që të hiqen nga hipoteka ne do të marrim masat konkrete.

Sa i përket pyetjes së Florentit për pronën komunale që gjendet para tregut të kafshëve ne e kemi gjetë ashtu dhe nuk e kemi leju me punu kompaninë “Kastrioti” mirëpo nuk kemi pasur mekanizëm për hekjen e asaj makinerie që gjindet aty por nuk do ta lejojmë që të punojë.

Pastaj tha se për këtë pronë kemi fillu procedurat për investime publiko private por dihet se duhet kohë për realizimin e tyre.

Sa i përket pyetjes së Luanit për shtruarjen e një rruge në Krojmir dhe vendosjen e pasqyrës në rrugën Dobrajë-Poturovc konsideroj se nuk do të ketë problem këto do të kryhen.

Sa i përket pengesave në fshatin Hallaq i Madh unë ju them se disa delegat në këtë Kuvend kanë kërku vendosjen e këtyre pengesave dhe tani kur këto janë vendos tani kërkojnë të hiqen, por unë ju them se nëse Kuvendi merr Vendim për hekjen e këtyre pengesave na si ekzekutiv menjëherë do t'i hjekim.

Sa i përket pyetjes për kontrata në vepër janë disa kontrata në vepër që i paguan DEMOS-i dhe një pjesë paguhen nga mallërat dhe sherbimet.

Për shkollën e Dobrajës është një Vendim dhe nuk ka ditë të caktuar për ditën e shkollës dhe po paragjykoj se as atëherë nuk kanë mund me u marr veshe mes veti për ditën e shkollës dhe unë nuk do ta imponoj këtë, do të mirren vesh familjet dhe kur ata e caktojnë ne do ta përkrahim e gjithashtu për këtë duhet të jetë pëlqimi i qytetarëve të Dobrajës, Këshillit të shkollës dhe dy familjeve.

Për këtë qështje unë kam biseduar edhe me shoqatat e dalura nga lufta si të nivelit lokal ashtu edhe qëndror të cilat kanë biseduar me këto familje por nuk kanë arritë që ta caktojnë datën për ditën e shkollës.

Sa i përket pyetjes për projektin e DEMOS-it aq sa ka qenë projekti është kryer puna dhe gjatë kryerjes së punëve ka qenë edhe një mbikëqyrje e rrept nga DEMOSI.

Qështja e pishinave u shtru me vend dhe inspektorët tanë në kuadër të kopetencave do të marrin masa të duhura.

Sa i përket kontinjerëve nëntokësor se kundërmojnë erë të rëndë kjo nuk qëndron kurse bartja e kontinjerëve prej një ane në anën tjetër kjo ndodh meqë pronarët e objekteve kur kanë ndërtuar objektin nuk kanë lënë vend për kontinjer andaj banorët i bartin herë në një anë herë në anën tjetër dhe për këtë kam formua një grup punues me i caktuar vendet sakt për kontinjer.

Sa i përket tenderit për Lumin “Sitnicën” e ka fituar kompania që ka qenë më e lira dhe mjetet që mbasin nga ky tender kam bisedu me ministritë përkatëse dhe do të nënshkruhet kontrata menjëherë për vazhdimin e fazës së dytë deri në kufi me Ferizajin.

Sa i përket pyetjes së Alisë për hedhjen e mbeturinave na i kemi parapa disa mjete me buxhet dhe do t'i heqim ato mbeturina por është vështirë pastaj t'i mbajmë.

Sa i përket rrugëve të arave që janë mbyll nga BECTEL ENCA ato kanë me u rregullu e gjithashtu rruga “Sadik Shala” do të vazhdoj prej lagjes së Akllapit dhe do të lidhet me magjistralen Prishtinë-Ferizaj dhe në këtë rrugë do të kenë qasje edhe Konjuhi dhe me rishikim të buxhetit e kemi parapr këtë rrugë për këtë vit dhe do të financohet nga Ministrija.

Për “Jetën e Re” ju e dini se nuk është përfshi me Statut dhe kërkoj që në seancën e ardhshme të aprovohet me plotësim të Statutit.

Konsideroj që u përgjigja në pyetjet që i parashtut.

Hajrije Salihu, unë Kryetar kur fola nuk fola me ngarkesë politike dhe mua po më dudet se po folni indiferent sikur për borën e parvjetëshme. E tha se të mirren vesh familjet në mes veti dhe mendoj se kjo nuk u takon familjeve të dëshmorëve dhe mllëfi i popullatës

po rritet dhe unë i pashë bashkëluftetarët e tyre se kishin një mllef të jashtëzakonshëm se ata nuk kanë bërë luftë për poena politik, andaj duhet së shpejti me u bërë një zgjidhje për këtë qështje.

Enver Kozhani, Kryetari tha se nëse Kuvendi merr Vendim për hjekjen e këtyre pengesave na do t'i hjekim menjëherë dhe unë e di që kjo nuk është qështje e Kuvendit dhe ju njoftova se kjo është kërkesë e qytetarëve dhe 36 familje e kanë nënshkruar peticionin dhe unë nuk kërkoje që të hiqen tërësisht por së paku të zvoglohen meqë janë jasht standardeve.

Ramiz Qeriqi, unë dua ta jap një kontribut lidhur me diskutimin e profesoreshtë Hajrije që ka të drejtë dhe ju them se në Krojmir janë 4 dëshmorë ku 3 dëshmorë kanë rënë në një ditë kurse një dëshmorë ka ra një ditë tjetër me 22 maj dhe na e kemi marr ditën kur ka rënë Halil Meta 22 maji. Neve si Kuvend nuk na takon me vendos por mund t'i ndihmojmë dhe këtë duhet ta vendosin Këshilli i shkollës, Këshilli i fshatit dhe shoqatat e dalura nga lufta.

Imri Ahmeti, Ju Enver në Kuvend keni kërkuar vendosjen e pengesave kurse tani kërkon me i hjekë.

Sa i përket shkollës së Dobrajës unë nuk imponoj por duhet të arrihet marrëveshjet që ceka më herët dhe ju them se nuk kam anu në asnjërën anë se sikur të kisha anu e kisha caktu ditën e shkollës.

Heset Sahiti, tha nga Këshilli fshatit Hallaq i Madh janë vendosur pengesat dhe janë pak të larta por nuk janë jasht standardeve. Unë nga sot kam me u angazhu me i hjek ato pengesa dhe kam me i vendos të gomes sipas standardeve.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 28 dhe 29-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet nga procesverbali i mbledhjes së 28 dhe 29-të të Kuvendit?

Ali Stublla, unë nuk po e shoh emrin tim se kam prezantuar .

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim ekstraktet dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 votat për të anëtarëve prezent

Aprovoi

Ekstraktet nga procesverbali i mbledhjes së 28 dhe 29-të të Kuvendit me vërejtjen e Ali Stublles

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendim për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Shkelzen Hajdinit, Drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me procedurat e hartimit të kornizës buxhetore si dhe me të dhënat nga korniza buxhetore duke shtuar se në këtë kornizë duhet ta nxjerrim edhe një aneks që t'i bashkangjitet kësaj kornize e që ka të bëjë me barazi gjinore. Pastaj tha se kemi tri ndryshime të investimet kapitale si vinon:

- Në Gadime shuma e paraparë prej 40 mijë euro rritet në 50 mijë euro.

- Në Teqe ku është thënë asfaltimi i rrugës duhet të thuhet kanalizimi ndërsa shuma nuk ndryshon është e njëjtë.
- Planifikim për nxemjen qendrore për Rufc të Ri dhe Dobrajë.
Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, ne dëgjuam Drejtorin e gjithashtu edhe dje në KPF e kemi shqyrtuar këtë kornizë buxhetore dhe sipas saj shihet se kemi rritje të buxhetit në krahasim me vitet e laluara e gjithashtu edhe për vitet vijuese ka rritje sidomos të investimet kapitale ku në vitin 2019 shuma shkon mbi 4 milion euro për investimet kapitale.

Te planifikimi i buxhetit për vitin 2017 ka rritje edhe të infrastruktura, shëndetësia dhe arsimi.

Për vitin 2018 është planifiku ndërtimi i qerdheve të fëmijëve për disa fshatra.

Blerim Gashi, disa qështje i kemi shqyrtu edhe në KPF dhe shqetësimi ynë është rritja e të hyrave vetanake që vështir mund ta realizojmë andaj kërkoj që si Kuvend t'i bëjmë një shkresë Ministrisë për Financa për zvogëlimin e të hyrave vetanake.

Lulzim Rustemi, na si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu këtë dokument dhe konsiderojmë se kjo kornizë ka të meta dobësi dhe mangësi dhe nuk korespondon me të dhënat për shtyllat që janë dhënë në kornizë dhe është buxhet që nuk garanton rritje ekonomike. Parimet që janë vendos për përmirësimin e standardeve në arsim nuk mund të kënaqemi në rritjen në arsim dhe saktësisht kemi degradim në arsim dhe kemi ndërhyrje politike.

Planifikimi në bujqësi është i vogël dhe konsiderojmë se ky planifikim duhet të rritet meqë bujqësia është i vetëmi sektorë që garanton punësim.

Përmirësimi në shëndetësi është një prioritet i cili gjërë tani nuk ka dhënë rezultate të pritshme dhe ka pasur mungesa sidomos në shërbimet elementare.

Infrastruktura rrugore ka një përmirësim mirëpo ka edhe të metat e veta dhe projektet që realizohen në teren kryesisht janë projekte të vogla kështu që projektet kryesore nuk po realizohen.

Te të hyrat vetanake është një rritje e madhe që nuk besoj që mund të realizojmë dhe duhet të kërkojmë zvogëlimin e tyre.

Te gjobat në trafik është një planifikim që ka rritje dhe nuk besoj se mund të realizohet.

Te ndryshimi i projektit "Adem Jashari" ky projekt nuk mund të ndryshohet dhe nuk ka bazë ligjore për ndryshim.

Te investimet kapitale janë shumë projekte që kanë shuma të vogla dhe më shumë bëhet për fushatë elektorale.

Rrugët që janë planifiku duhet të dihen sakt se cilat rrugë janë në cilat lagje dhe deri në shtator duhet të caktohen me këtë buxhet.

Kemi lokalitete që nuk kanë fituar fare e disa lokalitete kanë shkuar deri te ndriqimi. Në fund tha se shkolla e Kleçkes dhe e Krojmirrit kanë nevojë për meremetim dhe duhet të planifikohet.

Petrit Kelmendi, shumë qështje që dashta t'i them i thanë parafolësit por unë propozoj që të mallërat dhe shërbimet të bëhet zvogëlimi i shumës së mjeteve dhe këto mjete të parashihen në kategorinë për investime kapitale.

Për katër fshatrat Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Ribar i Vogël dhe Hallaq i Vogël propozoj që të parashihet ndërtimi i një objekti për sport dhe rekreacion.

Te projekti "Adem Jashari" ka qenë një projekt që ka aprovuar ky Kuvend dhe pyes se a është ai projekt që do të realizohet me faza apo planifikohet projekt i ri.

Kam edhe një kërkesë për zonën ekonomike që të parashihet kostoja buxhetore për infrastrukturë dhe të fillon që nga viti 2017.

Edita Gashi, ky buxhet kryesisht është përqëndru në rregullimin e infrastrukturës dhe infrastruktura është përqëndru në lokalitetet ku kjo qeverisje ka interesat e veta politike. U tha nga z. Lulzim Rustemi se me këtë buxhet nuk do të ketë zhvillim ekonomik dhe nuk prekë mirëqenjen e qytetarëve dhe si i tillë Lëvizja Vetvendosje është kundër.

Burbuqe Ilazi, me këtë kornizë buxhetore e pashë se shumë fshatra do të lidhen me rrugë në mes vete por nuk e pashë rrugën që lidh Torinën me Ribar të Vogël e pse jo edhe me Ribar të Madh.

Petrit Kelmendi, u fol për rritjen e tavanit të të hyrave vetanake e gjithashtu u tha se është vështirë të realizohet ky tavan por unë mendoj se këto të hyra vetanake do t'i realizojmë meqë në vitin e ardhshëm do të kemi legalizimin e objekteve dhe do të aplikohet taksa për toka.

Ukë Kryeziu, edhe ne si grup parlamentar i AAK-së e kemi shqyrtu këtë projekt të buxhetit dhe unë do të ndalem te planifikimet për infrastrukturë dhe është mirë që Drejtorati gjatë planifikimit për infrastrukturë të ketë parasysh edhe kontributet e lokaliteteve në mënyrë që ato kontribute t'u kthehen qytetarëve të atyre lokaliteteve. Unë nuk do të jem lokalist por po e përmendi disa projekte të fshatit Sllovi që kanë qenë të planifikuar për vitin 2016 janë bartë në vitin 2017 e gjithashtu projekti për rregullimin e trotuarit ku shuma ka qenë e planifikuar 75 mijë euro tani është zvogëluar në 60 mijë euro.

Projekti për asfaltimin e rrugës Smallushë-Sllovi ka kalua për investim për ministri. Në fund kërkoj që të përfundohet rruga në mes të fshatit Dobratin dhe Sllovi i cili projekt ka filluar në vitin 2013 dhe akoma një pjesë e rrugës nuk ka përfunduar.

Enver Kozhani, për asfaltimin e rrugëve në Ribar të Madh janë parapa mjete në shumë prej 45 mijë euro dhe pyes se cilat rrugë janë dhe propozoj që më mirë është të shtrohen rrugët e varrezave.

Ali Stublla, për "Jetën e Re" janë parapa dy projekte në shumë prej 25 mijë euro pyes se qka mund të bëhet me 25 mijë euro, e gjithashtu për Topliqan nuk është parapa ujësjellësi.

Hajrije Salihu, paraqiti shqetësimin e qytetarëve të fshatit Rubovc lidhur me kanalizim dhe është thënë se kanalizimi për këtë fshat do të parashihet në këtë vit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ta kuptojmë drejt zhvillimin ekonomik dhe na nuk kemi parametra tjerë përveq atyre parametrave që janë në nivel vendi. Është lehtë me kërkë zvogëlimin e të hyrave vetanake por nuk kemi realizim të projekteve pa realizimin e të hyrave vetanake dhe se të hyrat vetanake qdo vit ka pasur rritje.

U kërkë emërtimi i rrugëve por një dihet se mjetet që janë parapa për Ribar ato do të shkojnë në Ribar dhe deri në shtator do t'i keni edhe emrat e rrugëve. Pat edhe propozime për projekte të reja atëherë ju lutem thoni cilin projekt me hjek dhe me futë një tjetër projekt për cilin fshat.

Te kanalizimet ju e dini se kemi probleme por janë probleme që i kemi trashëguar dhe mos më ktheni prapa.

Na me këtë kornizë kemi parapa kanalizime e në kuadër të saj është edhe Rubovci.

Për rrugën në Sllovi e kemi kontratën të hapur dhe ende kemi borxh për këtë rrugë por ky projekt duhet me u vazhdu.

Mos mendoni se nuk kemi vullnet me e kryer të gjithë infrastrukturën në të gjitha fshatrat por mundësitë janë tjera. Në fund kërkoj që kjo kornizë të aprovohet si e tillë dhe në shtator do të kemi edhe emrat për rrugët.

Xhevat Olluri, në pikën 9-te e kemi planin e mobilitetit urban dhe me këtë plan parashihet një kosto andaj propozoj që kjo kosto të hynë në këtë kornizë buxhetore.

Enver Kozhani, falenderoj Kryetarin për përgjigje por kërkoj që nga mjetet e parapara në shumë prej 45 mijë euro të ndahën 25 mijë euro për rrugët e varrezave.

Ali Stublla, Kryetari përmendi rrugën Topliqan Vojnovc mirëpo unë propozoj që kjo rrugë të hiqet dhe të parashihet ndërtimi i rrugës Topliqan-Kojuskë që është më e arsyeshme.

Për “Jeten e Re” janë dy projekte asfaltimi dhe ujësjellësi dhe unë propozoj që së pari të realizohet projekti i ujësjellësit e pastaj asfaltimi. Në vazhdim tha se me këtë kornizë janë parapa 117 projekte dhe nuk e dijë se sa kanë mundësi me i menaxhu këto projekte 4-5 inxhinier apo sa kemi.

Imri Ahmeti, tha se vitin e ardhshëm duhet me e parapa edhe mirëmbajtje e rrugëve dhe sigurisht mjetet për mallëra dhe shërbime duhet të rriten.

Te plani i mobilitetit e përmendi me të drejtë Xhevati dhe duhet të parashihen mjete.

Meqi diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin Vendimin së bashku me kornizën buxhetore me propozimin për ndryshim që kësaj kornize t’i bashkangjitet edhe aneksi për barazi gjinore të cilën e ceku Drejtori i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, miratoi këtë:

VENDIM

MBI APROVIMIN E KORNIZES AFATMESME BUXHETORE 2017-2019

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019 për Komunën e Lipjanit

Neni 2.

Me , Kornizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019
Grant i Përgjithshëm	4,545,468.00	4,851,281.00	5,090,886.00
Grant Specifik i Arsimit	5,784,564.00	5,784,564.00	5,784,564.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,426,679.00	1,426,679.00	1,426,679.00
Të hyrat vetanake	2,108,547.00	2,108,547.00	2,135,237.00
Financimi Sherbimet Rezedenciale	160,000.00	0.00	0.00
TOTALI	14,025,258.00	14,171,071.00	14,437,366.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019
Paga e Mëditje	8,885,900.00	8,885,900.00	8,885,900.00
Mallra dhe Shërbime	959,100.00	922,413.00	922,413.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	190,098.00	190,098.00	190,098.00
Subvencione dhe Transfere	325,160.00	325,160.00	325,160.00
Investimet Kapitale	3,665,000.00	3,847,500.00	4,113,795.00
TOTALI	14,025,258.00	14,171,071.00	14,437,366.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 pas rexhistrimit në zyrën e protokolit në MAPL dhe publikimit në Web faqen e Komunës.

Neni 6

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim Vendim për Hapjen e Trasesë së Rrugës në Zonën Kadastrale Konjuh

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashilli, Drejtor i DPU-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit..

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, sigurisht është marr pëlqimi nga pronarët e tokave dhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Florent Hoxha, qdo hapje e rrugës është në interes edhe të Komunës dhe qytetarëve dhe me këtë rrugë lidhet Lipjani me magjistralen Prishtinë-Ferizaj.

Blerim Gashi, edhe na e përkrahim këtë propozim Vendim dhe unë nuk e pashë në këtë vendim se ka persona privat që u mirret toka.

Ramiz Qeriqi, kur janë dhënë pronat në shfrytëzim Komuna pasur obligim për rregullim të infrastrukturës e që gjer tani nuk e ka bërë.

Xhevat Olluri, kjo rrugë ka qenë me plan rregullativ.

Imri Ahmeti, për këtë rrugë kërkesa ka qenë e kahershme e gjithashtu edhe në mandatin e juaj dhe këtu nuk preken pronat private por vetëm pronat e atyre që e kanë marrë në shfrytëzim dhe e kemi pëlqimin e tyre për hapjen e kësaj rruge.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, miratoi këtë:

VENDIM

PËR HAPJEN E TRASESË SË RRUGËS NË ZONËN KADASTRALE KONJUH

Neni 1

1.Me këtë Vendim hapet traseja e rrugës me gjërësi prej 5 metrave në pjesët e parcelave kadastrale si në vijim:

1.1 P-71409036-00164-2 në vendin e qujtur “Branjesh” me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 620m² (sipërfaqe e tërsishme 13756m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.Kuvendi Komunal Lipjan.

1.2 P-71409036-00164-17 në vendin e qujtur “Branjesh” me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 922m² (sipërfaqe e tërsishme 10093m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.Kuvendi Komunal Lipjan.

1.3 P-71409036-00164-25 në vendin e qujtur “Branjesh” me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 1292m² (sipërfaqe e tërsishme 8061m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.Kuvendi Komunal Lipjan.

1.4 P-71409036-00164-24 në vendin e qujtur “Branjesh” shfrytëzimi aktual oborr, shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe prej 489m² (sipërfaqe e tërsishme 28910m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.KK Lipjan shfry.99 vite N.PQ “Lesna” Sh.p sipas kontratës 1-464-153 dt.26.07.2006.

1.5 P-71409036-00164-23 në vendin e qujtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 1197m² (sipërfaqe e tërsishme prej 15000m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.KK Lipjan shfry.99 vite Standard Benz Sh, sipas kontratës 1-464-154 dt. 26.07.2006.

1.6 P-71409036-00164-28 në vendin e qujtur "Branjesh" me kulturë arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 569m² (sipërfaqe e tërsishme 15000m²) e evidentuar në Certifikatën 3347/16 ZK Konjuh PSH.KK Lipjan shfry.99 vite UBT Sh.p sipas marrëveshjes nr.ref.16303 009 058 611 tetor 2009.

Neni 2

Hapja e trasesë së rrugës në pjesët e parcelave kadastale bëhet me qëllim që të iu mundësohet titullarëve të pronave private të kanë qasje në pronat e tyre e që për momentin këto prona nuk kanë qasje në rrugë. Gjithashtu rruga e cila do të hapet do të shërbejë edhe për bizneset.

Mundësia e hapjes së trasesë së rrugës së re ekziston pasi janë dhënë pëlqimet nga shfrytëzuesit e pronave komunale siq është përcaktuar në nenin 1 paragrafi 1.4, 1.5, 1.6 të këtij vendimi.

Neni 3

Kushtet ndërtimore dhe procedurat tjera që rezultojnë në zbatimin e këtij vendimi do të jenë në harmoni me rregullativën ligjore nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për caktimin e kufijve të rrugës dhe ta regjistroj në librat publike rrugë publike sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12,35 Kryesuesja dha pauz deri në ora 13,30
Pas pauzës në ora 13,50 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt.

IV

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së "MABCO CONSTRUCTIONS" SHPK të përzgjedhur nga Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit si dhe procedurat e hartimit të këtij Vendimi duke shtuar se kjo pronë ipen në shfrytëzim për 99 vite dhe gjendet në fshatin Banullë dhe në këtë pronë do të ndërtohet Fabrika e kpurdhave ku do të punësohen 120 punëtorë të rregull dhe disa punëtorë sezonal.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, na jemi pro këtij propozim Vendimi dhe unë e kam lexu planin e biznesit që arsyeton plotësisht këtë projekt. Në vazhdim tha se gjatë nënshkrimit të kontratës të parashihet edhe formimi i një komisionit që do të formohet për pranimin e punëtorëve në të cilin komision do të përfshihen nga Komuna e gjithashtu me një nen të veçantë të parashihet që punësimi i punëtorëve të bëhet nga Komuna e jonë.

Lulzim Rrustemi, ky Vendim ka të bëjë me zhvillimin ekonomik dhe na si grup parlamentar e përkrahim. Në vazhdim tha se ne jemi dhënë sipërfaqe të mëdhaja të tokës dhe konsideroj se në këtë sipërfaqe është dashtë të jenë 2-3 kompani.

Ukë Kryeziu, edhe na si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë propozim Vendim dhe e përkrahim me që këtu bëhet një investim prej 7 milion euro.

Blerim Gashi, edhe na e përkrahim këtë propozim vendim meqë është një projekt gjigant që gjerë më tani nuk ka ndodh te ne dhe konsideroj se procedurat janë zbatu me përpikëri nga komisioni.

Linda Shahini, me qenë se jam anëtare e komisionit dhe sipas projektit shihet se do të punësohen 120 punëtorë të rregullt dhe 120 sezonal andaj kërkoj që gjatë punësimit të respektohet barazia gjinore 50 me 50%.

Vlora Limani-Hajnuni, te neni 3 të plotësohet dhe të thuhet: gjatë hartimit të kontratës të parashihet formimi i një komisioni të përbashkët për pranimin e punëtorëve në të cilin komision do të përfshihen nga Komuna, Kompania dhe enti për punësim.

Hajrije Salihu, unë pajtohem që gjatë pranimin të punëtorëve të merret parasysh barazia gjinore 50 me 50%.

Blerim Gashi, mua nuk po më duket reale që në komision për punësim të përfshihet edhe enti i punësimit meqë për këtë vendos kompania.

Xhevat Olluri, kërkoj që gjatë punësimit të ketë të drejta të barabarta e jo ta kushtëzojnë me 50% të femrave.

Daut Azemi, na po ju japin tokat në shfrytëzim kompanive kurse ato punëtorët po i marrin nga komuna tjera dhe është mirë që kur t'i japim tokat në shfrytëzim t'i kushtëzojmë që punëtorët të merren nga Komuna jonë.

Ali Stublla, edhe unë e përkrahi mendimin e parafolësve që gjatë nënshkrimit të kontratës të parashihet formimi i komisionit të përbashkët për pranimin e punëtorëve.

Florent Hoxha, a kemi të drejtë ligjore që na të kërkojmë që në komisionin për pranim të punëtorëve të përfshihet nga Komuna dhe Enti për punësim.

Ukë Kryeziu, kompania Eskavatori në vitin 2007 e ka nënshkruar kontratën dhe na si fshat e kemi kushtëzu që 50% të punëtorëve të pranohen nga Sllovia. Andaj propozoj që të qitet në votim propozimi për formimin e komisionit të përbashkët për pranimin e punëtorëve në të komision do të përfshihen anëtar nga kompania, Komuna dhe Enti për punësim.

Florent Hoxha, edhe na jemi që shumica e punëtorëve të jenë nga Komuna jonë dhe kontratën që e nënshkruan kompania nëse nuk zbatohet pasojnë masat.

Lulzim Rrustemi, Komuna nuk mund të jetë pjesë e komisionit por për punëtorët mund të parashihet me kontratë që të jenë nga Komuna jonë.

Vlora Limani –Hajnuni, Kryesuese, vuri në votim propozimin e Agronit për formimin e komisionit të përbashkët në të cilin komision do të jenë përfaqësues nga Komuna, Kompania dhe Enti dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 14 vota për 12 kundër miratoi propozimin për formimin e komisionit siqë u cek më lart.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit së bashku me propozimin e aprovuar për formimin e komisionit të përbashkët dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË “MABCO CONSTRUCTIONS” SH.P.K TË
PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , oferta e për zgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. “MABCO CONSTRUCTIONS” SH.P.K, është shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Prona e paluajtshme e Komunës, gjendet në fshatin Banullë, Zona kadastrale Banullë , me sipërfaqe prej **2.80,18 ha**(dy hektar e tetëdhjetë ari e tetëmbëdhjetë metra) parcela kadastrale Nr.P-71409003-00926-0 vendi i quajtur “Rosula”, arë e klasës së 4-të e evidentuar në çertifikatën nr.3990/2016.
3. Shfrytëzimi i pronës do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Në pronën e cekur do të ushtrohet veprimtaria: ndërtimi i fermës për prodhimin e këpurdhave eringi.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me kontratë të parashihet formimi i Komisionit të përbashkët për pranimin e punëtorëve i cili Komision do të përbëhet nga përfaqësues të Komunës, Entit për Punësim dhe kompanisë “MABCO CONSTRUCTIONS” SH.P.K

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Zyra e Kryetarit të Komunës - sektori pronesor-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimit.

V

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së “TROPIKANA AL MINING” SHPK të për zgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi Vendimi si dhe punën e Komisionit për shqyrtimin e ofertave.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Xhavit Maholli, a është kjo ndërmarrje e re apo e vjetra.

Avni Olluri, jo është ajo ekzistuese.

Linda Shahini, na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendi.

Blerim Gashi, për me qenë drejt dhe korrekt kërkoj që edhe në këtë Vendim të parashihet formimi i komisionit për pranimin e punëtorëve si në Vendimin e parë.

Lulzim Rrustemi, këtë Vendim e kemi pasur edhe më heret në shqyrtim dhe e kemi aprovu por për shkak të shkeljeve ligjore është kthyer nga Ministria dhe kemi të bëjmë me të njejtën kompani dhe punëtorët i ka të punësuar por që 2 vite i ka skaduar kontrata.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit që edhe në këtë rast gjatë nënshkrimit të kontratës të parashihet formimi i komisionit të përbashkët nga Kompania, Komuna dhe Entit për punësim dhe pas votimit konstatoi se 13 vota për, 10 kundër, Kuvendi aprovoi propozimin e Blerimit për formimin e Komisionit.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË “TROPIKANA A&L MINING “ SH.P.K TË
PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT
Neni 1

MIRATOHET , oferta e përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

5. “TROPIKANA A&L MINING “ SH.P.K, është shfrytëzues i pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Prona e paluajtshme e Komunës, gjendet në fshatin Babush i Muhagjerëve, Zona kadastrale Babush, me sipërfaqe prej **0.50,00 ha** (pesëdhjetë ari) nga parcela kadastrale nr.P-71409059-00562-1 vendi i quajtur “Ballkan”, kullosë e klasës së 5-të me sipërfaqe të përgjithshme prej 21.16,66 ha e evidentuar në certifikatën nr.3990/16.
7. Shfrytëzimi i pronës do të jetë 20 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
8. Në pronën e cekur do të ushtrohet veprimtaria : Prodhimtaria e eksplozivit, eksport, import, transit dhe transferim të eksplozivëve dhe fishekjarrëve.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës-Komunës

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me kontratë të parashihet formimi i Komisionit të përbashkët për pranimin e punëtorëve i cili Komision do të përbëhet nga përfaqësues të Komunës, Entit për Punësim dhe kompanisë “TROPIKANA A&L MINING “ SH.P.K.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Zyra e Kryetarit të Komunës - sektori pronesor-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë:Vendimi.

VI

Propozim Vendim për Themelimin e Zonës Ekonomike në ZK Qylagë

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Latif Ramadani, Drejtor i Dzhe-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimit si dhe procedurat e zbatuara deri në nxerrjen e këtij Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Petrit Kelmendi, pyeti se a është bërë ndonjë planifikim me buxhet për rregullimin e infrastrukturës në këtë zonë ekonomike dhe kurë do të filloj imlementimi i këtij Vendimi.

Linda Shahini, na si grup parlametar e përkrahim këtë propozim Vendim meqë ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të komiunës.

Latif Ramadani, sa i përket planifikimit për rregullimin e infrastrukturës kemi parapa 2 milion dhe kemi bërë kërkesë në Ministrinë për Industri dhe Tregëti dhe besoj se do të na ndahën mjete për rregullimin e infrastrukturës.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, miratoi këtë:

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim për miratimin e nismës së Kuvendit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Lipjanit në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajlit, Drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim dhe është mirë që edhe Komuna jonë të merr iniciativa të tilla meqë ne kemi disa komuna që kufizohen me Komunën tonë.

Ukë Kryeziu, konsideroj se është një Vendim i mirë dhe i qëlluar dhe na e mbështesim si grup parlamentar.

Lulzim Rrustemi, natyrisht se ky propozim Vendim është në harmonizim me Ligj por unë kamë vërejtje se gjatë prezantimit të këtyre vendimeve të paraqiten me projektor se na nuk e dijmë se cila pjesë e rrugës është të territorin e Komunës së Lipjanit.

Xhevat Olluri, unë e di që se 1 km e 200 m rrugë e përfshinë territorin e Komunës së Lipjanit.

Adelina Krasniqi, edhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim meqë është në interes të qytetarëve.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se 27 vota për, Kuvendi miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E NISMËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E LIPJANIT NË FUSHËN E
INFRASTRUKTURËS RRUGORE ME INTERES TË PËRBASHKËT

Neni 1

MIRATOHET, Nisma e Kuvendit të Komunës së Gjilanit sipas Vendimit nr 01.nr.016-57259 të datës 14.06.2016, për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Lipjanit në fushën e infrastrukturës rrugore për realizimin e projektit në interes të përbashkët në **rikonstruimin e rrugës** “Zhegoc-Verbicë e Zhegocit prej rrugës së asfaltuar Ponesh-Zhegoc te Bulevardi i Dëshmoreve deri në rrugën e asfaltuar në fshatin Sllovi Komuna e Lipjanit.

Neni 2

Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunën e Gjilanit. Detajet e bashkëpunimit do të përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shetsë: Vendimi.

VIII

Propozim Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Gjilanit në fushën e infrastrukturës rrugore me interes të përbashkët.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemaji, Drejtor i DA, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propzim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Lulzim Rrustemi, kjo kopetencë është kopetencë ekskluzivisht e Kuvendit dhe nuk kemi arsye me ja bartë Kryetarit kjo është e parapar me nenin 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe ne grupi parlamentar i PDK-së jemi kundër kësaj Vendimi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 14 vota për, 11 kundër miratoi këtë:

V E N D I M
PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR PËRFAQËSIMIN E
KOMUNËS SË LIPJANIT PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNËN E
GJILANIT NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE ME INTERES TË
PËRBASHKËT

Neni 1

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit, gjatë bisedimeve për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Gjilanit, në fushën e infrastrukturës rrugore, në realizimin e projektit në interes të përbashkët për rikonstruimin e rrugës “Zhegoc-Verbicë e Zhegocit prej rrugës së asfaltuar Ponesh-Zhegoc te Bulevardi i Dëshmoreve të Komunës së Gjilanit deri në rrugën e asfaltuar në fshatin Sllovi, Komuna e Lipjanit dhe në bazë të këtyre konsultimeve të përgatitet marrëveshja e cila do të

nënshkruhet dhe të miratohet konform dispozitave të nenit 8 par.2 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal .

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IX

Propozim Vendim për miratimin e Planit të mobilitetit urban për Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Heset Sahiti , Drejtor i DSHP i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit si dhe me planin e mobilitetit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, unë falenderoj DEMOS-in për punën që kanë bërë në hartimin e këtij plani dhe unë si Kryesues i Komiteti për Shërbime Publike kamë marr pjesë në hartimin e këtij plani, andaj ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë plan.

Xhevat Olluri, ky është një plan i mirë dhe na e përkrahim mirëpo për shkak të kostos financiare e dijë se nuk kanë mundur me u përfshi disa qështje si shembull po e marr se na e kemi hekurudhen në mes të qytetit dhe rruga që vjen nga Banulla duhet me e kalu hekurudhen andaj është mirë mu parapa një rrugë që lidh rrugën e Banullës me lagjen në Lipjan andej hekurudhe. Gjithashtu në bashkëpunim me hekurudhen duhet të parashihet një nën kalim apo mbi kalim te hekurudha.

Enver Kozhani, edhe ne falenderojmë përfaqësuesit e DEMOS-it që janë prezent këtu e gjithashtu e përkrahim këtë plan.

Ermira Salihu, përfaqësuese e DEMOS-it tha se planin e keni marr dhe nëse dikush ka pyetje ne mund të përgjigjemi.

Heset Sahiti, sa i përket pyetjes së Xhevatit për nën kalim te hekurudha me planin urban është i parapar nën kalimi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24vota për, kundër nuk pati miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MOBILITETIT URBAN PËR KOMUNËN E LIPJANIT 2016-2020

Neni 1

MIRATOHET , Plani i mobilitetit urban për Komunën e Lipjanit 2016-2020 .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i mobilitetit urban për Komunën e Lipjanit 2016-2020.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë:Vendimi.

X

Propozim Vendim për Miratimin e Strategjisë për Informim dhe marrëdhënie me Publikun e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Ilir Tashollit Drejtor i DPU-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishme me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Lulzim Rrustemi, strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun është një fushë e gjërë dhe shumë e rëndësishme për komunën dhe le shumë për të dëshiruar. Komuna edhe më tutje që 3 vite është e mbyllur hermetikisht dhe kemi rastet edhe në prokurim edhe në investime kapitale ku nuk informohet publiku as shoqëria civile. Te Web faqja e Komunës së kemi ajo është e një anëshme dhe nuk e kemi asnjë rresht për opozitën a dihet opozita është pjesë e Kuvendit.

Qëllimi i Web faqes është të informoj drejt dhe sakt dhe mendoj se ende ka vend që Komuna të hapet për publikun dhe deri sa kjo nuk bëhet na si grup parlamentar jemi të pa kënaqur me informimin dhe nuk e përkrahim këtë strategji.

Vlora Limani-Hajnujini, z Rrustemi nuk është mirë me dezinformu publikun rreth materialeve të Kuvendit dhe qdo OJQ që është i interesuar e ka marr materialin por dihet se edhe ato duhet me respektu Rregulloren e Kuvendit dhe për ata që nuk e respektojnë nuk ka material.

Blreim Gashi, uroj së pari ky dokument i hartuar në letër të gjejë zbatim në praktikë.

Pastaj tha se Kuvendit i mungon një televizion për pransmetimin e punës së tij dhe është mirë që në të ardhmen të kontraktohet dikush për transmetimin e punës së Kuvendit.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për, 7 kundër, miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN E KOMUNËS SË LIPJANIT(2016-2018)

Neni 1

MIRATOHET, Strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun e Komunës së Lipjanit (2016-2018) .

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia për informim dhe marrëdhënie me publikun e Komunës së Lipjanit (2016-2018) .

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Administratë.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 16,⁰⁰

**Ekstraktin e hartoi
Sami Murati**

**Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni**